

URDHËR
Nr. 461, datë 16.3.2015

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 27 dhe 29 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministrit të Mbrojtjes z. Petro Koçi, i delegohet kompetenca për nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësimin e Ministrisë së Mbrojtjes në proceset gjyqësore, të padive të ngritura nga Ministria e Mbrojtjes, të ankimeve në Gjykatën e Apelit dhe rekurseve në Gjykatën e Lartë, ku palë e paditur/paditëse është Ministria e Mbrojtjes.

2. Autorizimet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

3. Ndjek dhe ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Mbrojtjes, sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Drejtoria Juridike.

4. Urdhri nr. 1909, datë 17.10.2013 i ministrit të Mbrojtjes, “Për delegim kompetence”, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
Mimi Kodheli